

## E DREJTA PËR INFORMIM

Zyra e Komisionerit zgjidhet të përfaqësojë ICIC në Konferencën për të Drejtat e Njeriut të OSBE

### Warsaw Human Dimension Conference

**WHEN:** 2 October 2023, 14:00 - 13 October 2023, 13:00

**WHERE:** Sofitel Victoria Warsaw Królewska St. 11, 00-065, Warsaw

**ORGANIZED BY:** The 2023 OSCE Chairpersonship of North Macedonia, with the support of the OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR)



Warsaw Human Dimension Conference (OSCE/Piotr Dziubak) Photo details

EVENT

#### Related news

United Nations High Commissioner for Human Rights Volker Türk to address OSCE Permanent Council in Vienna on 8 June  
Vienna , 6 June 2023

More determination needed by states to prevent breaches of international law and ensure accountability during conflict and crisis, OSCE leaders say  
Vienna , 24 April 2023

Greater efforts to counter Holocaust distortion needed to combat hate and protect democracy, OSCE says on International Holocaust Remembrance Day  
SKOPJE/WARSAW/WASHINGTON , 27 January 2023

[VIEW ALL NEWS](#)

Në mbledhjen e radhës së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) u vendos me votim unanimit Komitetit Ekzekutiv që Zyra e Komisionerit të përfaqësojë ICIC në një prej eventeve shoqëruese të Konferencës për të Drejtat e Njeriut (*Human Dimension Conference*) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), gjatë muajit tetor 2023 në Varshavë. Në këtë aktivitet, Zyra e Komisionerit do të referojë përvojën e saj në lidhje me zbatimin e Konventës 205 të Këshillit të Evropës (e njohur edhe si Konventa e Tromsos).

Ky është një vlerësim për autoritetin shqiptar, për rolin dhe kontributin në kuadër të veprimtarisë së organizatës më të rëndësishme botërore në fushën e të drejtës për informim.

**Vendim Nr. 34** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Vendim Nr. 35** - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

## Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit gusht 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit gusht 2023, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me vendimin nr. 34, datë 02.08.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") Formularin e Ankesës ku objekt i kërkesës është vënia në dispozicion e dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "F. V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore", konkretisht:

1. Kopje të urdhërit të prokurimit;
2. Kopje të dokumentacionit në lidhje me analizën e tregut për përcaktimin e fondit limit;
3. Kopje të urdhërit për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave;
4. Kopje të Raportit të Vlerësimit dhe kopje të raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave;
5. Kopje të Ofertës së fituesit të kontratës;
6. Kopje të Kontratës së nënshkruar më fituesin e procedurës së prokurimit;
7. Kopje të faturave dhe pagesat e kryera;
8. Kopje të vërtetimit të realizimit me sukses të procedurës së prokurimit.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisio-

nerit, ka kërkuar nga Autoriteti Publik lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit /dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion.


Autoriteti Publik, ka sqaruar se: "...Procedura prokurimit është një procedurë e zhvilluar me mjete elektronike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dhe për rrjedhojë informacioni mbi të është i aksesueshëm nga çdo person i interesuar. Duke qenë se një pjesë e dokumentacionit të kërkuar, (i cili nuk publikohet në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)) i përket fushës së zbatimit të nenit 81 "E drejta për informim" dhe nenit 99 "Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit" të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Autoriteti Publik përpara se të vendosë në dispozicion kopje të tij, do t'i drejtohet me kërkesë për interpretim Agjencisë së Prokurimit Publik në mënyrë që të mos veprojë në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ose të cënojë interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose të pengojë konkurrencën e drejtë".

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe në kushtet kur Autoriteti Publik pranon se e disponon dokumentacionin, objekt ankese, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuar çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuar. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për për vënie në dispozicion të informacionit /dokumentacionit sipas kërkesës.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

# Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC).



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC).


Në këtë takim u trajtuan çështje të rëndësishme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së organizatës: u prezantua Raporti i punimeve të edicionit të 14-të të Konferencës së ICIC, mbajtur gjatë muajit qershor si dhe u dakordësua në parim ngritja e Komitetit të Planifikimit për organizimin e edicionit të 15-të ICIC në Shqipëri, në vitin 2024. Në lidhje me këtë çështje, përveç autoritetit të Meksikës (INAI) dhe Zyrës së Komisionerit, për t'u bërë pjesë e tij shprehën interes edhe institucionet homologe nga Mbretëria e Bashkuar (ICO), Gjermania (BfDI), Afrika e Jugut (IR) apo Argjentina (OGDAI).

Komiteti Ekzekutiv aprovoi edhe anëtarësimin e autoritetit të Sri Lankës në rradhët e ICIC.

## Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMDP)